



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË MAT

Nr. 772 Prot.

Burrel, më 14.05.2019

NJOFTIM

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË MAT

SHPALLJE VENDI VAKANT PËR NJË VEND TË LIRË PUNE POZICIONI KORDINATOR

Në respektim të Ligjit 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat shpall vendin vakant për:

Pozicioni: Koordinator për asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm

Institucioni: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat

Autoriteti i emërtesës: Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat

PËRGJEGJESITE KRYESORE:

Punonjësi përmbush detyrimet e prokurorisë për informacion ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, referimin e viktimave tek ofruesit e shërbimeve dhe garantimin e mundësive për ushtrimin efektiv të të drejtave të tyre. Punonjësi ndihmon çdo pjesëmarrës në procedim që ka një paaftësi fizike apo mendore për të ushtruar me efektivitet të drejtën për akses në sistemin e drejtësisë penale.

Funksionet kryesore:

Ofron shërbime dhe këshilla për viktimat e krimit, në veçanti për ato të kategorive të mëposhtme: të miturit; viktimat e dhunës në familje, abuzimit seksual dhe përndjekjes; viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe viktimat me paaftësi fizike dhe intelektuale, duke pasur parasysh moshën dhe situatën specifike.

U shpjegon viktimave procesin e drejtësisë penale dhe procedurat e ndryshme gjyqësore.

Merr informacion, siguron mbështetje emocionale dhe ndërhyrje në rastet e krizës si dhe bën referime tek ofruesit shtetëror dhe ato jofitimprurës të shërbimeve.

Shërben si ndërlidhës ndërmjet prokurorit të rastit dhe viktimës.

Kryen detyrat nën drejtimin e prokurorit të çështjes dhe brenda kufijve të sekretit hetimor. Në rast mospërputhesh i raporton ato tek prokurori i çështjes.

Mban kontakt me viktimën dhe dëshmitarin gjatë fazave të procedimit penal, duke dhënë mbështetje emocionale dhe informacion praktik, sipas nevojës.

Vepron si ndërlidhës me agjensitë e arsimit dhe shërbimet sociale në komunitet.

Krijon dosje të rasteve, sipas udhëzimeve të marra nga drejtuesi i prokurorisë.

Përditëson rregullisht udhëzimet, politikat dhe procedurat standarde të operimit të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm

Kryen detyra të tjera që i caktohen nga prokurori apo drejtuesi i prokurorisë.

Arsimi, trajnimi dhe eksperiencia:

Kriteret e nevojshme

Të jetë shtetas shqiptar.

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar e të folur.

Të jetë fizikisht i aftë për të kryer detyrën.

Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë një hetim penal në proces;

Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e konkurimit.

Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për psikologji, sociologji, ose fusha të tjera të ngjashme.

Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë, ofruesit e shërbimeve, që operojnë në komunitet, viktimat dhe publikun.

Të ketë aftësi për të ndërvepruar në mënyrë efektive dhe me takt me viktimat emocionalisht të shqetësuara.

Të ruajë sekretin hetimor.

Të ruajë konfidencialitetin e informacionit të viktimës.

Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale.

Të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme në lidhje me viktimat e krimit.

Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si: Microsoft Word, Excel, PowerPoint, etj.

Kritere të preferuara, por jo të nevojshme:

Njohja e shërbimeve që u ofrohen viktimave të krimit nga ofrues të ndryshëm shtetërorë dhe jo qeveritarë.

Njohja e sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore.

Kualifikimet e paraqitura më lartë janë udhëzime. Gjatë shqyrtimit të kandidatave, mund të merren parasysh kombinime të tjera të arsimit dhe përvojës, të cilat mund të ofrojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer detyrën.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 10 ditëve pas publikimit të njoftimit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, nga e hëna në të premte ora 8.00-16.00.

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT PRANË PROKURORIA PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË MAT**